

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**LIGJI nr. 02/L-126**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN**  
**E LIGJIT NR. 2004/46 PËR REGJISTRAT E GJENDJES CIVLE**

**Kuvendi i Kosovës,**

Në bazë të kreut 5.1 (i) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Me qëllim të efikasitetit të kryerjes së punëve të qytetarëve nga Shërbimi i gjendjes civile, krahas të arriturave bashkëkohore në këtë fushë dhe unifikimit të terminologjisë,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN**  
**E LIGJIT NR. 2004/46 PËR REGJISTRAT E GJENDJES CIVLE**

Neni 1

Në tërë tekstin e Ligjit për regjistrat e gjendjes civile nr. 2004/46, fjalët: “Librat amzë”, zëvendësohen me fjalët “Regjistrat themeltarë”, fjalët “Libri amzë i të lindurve” zëvendësohen me fjalët “Regjistri i të lindurve”, fjalët “Libri amzë i të martuarve”, zëvendësohen me fjalët “Regjistri i të martuarve”, fjalët “Libri amzë i të vdekurve”, zëvendësohet me fjalët “Regjistri i të vdekurve”, si dhe format dhe trajtat e tyre do të përshtaten sipas tekstit ku ndodhen ato.

Neni 2

Në nenin 2 shtohet përkufizimi “Broshura familjare”, ndërsa përkufizimet e tjera ndryshohen si vijon:

”**Broshura familjare**” është libër i veçantë, që u jepet bashkëshortëve me rastin e lidhjes së martesës;

“**Regjistrat themeltarë**” janë libra të gjendjes civile, në të cilat pasqyrohen të dhënat e gjendjes civile për të gjithë qytetarët e Kosovës si: lindja, martesë, vdekja dhe të dhëna të tjera, që burojnë prej tyre;

**Regjistri i të lindurve**”, është libri, në të cilin regjistrohen faktet e lindjes së qytetarëve në territorin amë;

“**Regjistri i të martuarve**” është libri, në të cilin regjistrohen faktet e martesës së qytetarëve të territorit amë;

“**Regjistri i të vdekurve**” është libri, në të cilin regjistrohen faktet e vdekjes së qytetarëve të territorit amë;

“**Zyra e gjendjes civile**” është zyrë, në të cilën kryhen shërbime nga gjendja civile për qytetarët e territorit të komunës;

### Neni 3

Neni 3.1, ndryshohet si vijon: “Regjistrat themeltarë janë libra të gjendjes civile, në të cilat pasqyrohen të dhënat e gjendjes civile për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Neni 3.2, ndryshohet si vijon: “Në regjistrat themeltarë regjistrohen faktet si: lindja, martesë, vdekja dhe të dhëna të tjera, të përcaktuara me Ligjin e gjendjes civile.”

Neni 3.3, ndryshohet si vijon: “Faktet e përcaktuara me Ligjin e gjendjes civile, si: lindja, martesë, vdekja dhe të dhënat e tjera, të qytetarëve kosovar që ndodhen jashtë territorit të Kosovës, regjistrohen në regjister të veçantë në zyrat komunale të gjendjes civile ku ata e kanë vendbanimin.”

Neni 3.5, ndryshohet si vijon: “Forma elektronike mbahet sipas udhëzimeve dhe programeve unike të ministrisë përkatëse.”

### Neni 4

Neni 4.1, ndryshohet si vijon: “Regjistrat themeltar për përdorim mbahen në zyrën komunale të gjendjes civile, kopjet e tyre ruhen përgjithmonë, në një objekt tjetër.”

Neni 4.2, ndryshohet si vijon: “Kur zyrtari i gjendjes civile mungon, zëvendësohet nga zyrtari tjetër me të gjitha autorizimet e tij.”

Neni 4.4, ndryshohet si vijon: “Për territorin amë, në zyrat e gjendjes civile mbahen : regjistri i të lindurve, i të martuarve dhe i të vdekurve.”

Neni 4.7, ndryshohet si vijon: “Regjistrat themeltarë mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik, duke shënuar “përfundon me numrat vijues” (shënohet me numra dhe germa numri i regjistrimeve për atë vit.”

### Neni 5

Neni 5, ndryshohet si vijon:

“5.1. Në faqen e parë të regjistratit themeltar shënohet:

- a. emri i regjistrit themeltar (regjistri i të lindurve, regjistri i të martuarve ose regjistri i të vdekurve;
- b. emri i zyrës dhe emri i komunës;
- c. data e regjistrimit të parë dhe të fundit;
- d. vula;
- e. nënshkrimi i zyrtarit kompetent të gjendjes civile;
- f. nënshkrimi i udhëheqësit të gjendjes civile, dhe
- g. numri i faqeve të regjistrit themeltar.”

5.2. Në rastet kur ndryshon emri i vendit, territorit amë ose i komunës ku mbahen regjistrat themeltarë, këto ndryshime shënohen si pikë e veçantë nga paragrafi 1 i këtij neni.”

#### Neni 6

Neni 6, ndryshohet si vijon:“Faktet e lindjes, martesës dhe të vdekjes regjistrohen në librat themeltarë në këtë mënyrë.”

#### Neni 7

Në nenin 8.3, fjala “Shënimet” zëvendësohet me fjalën “Faktet.”

#### Neni 8

Neni 11.3, ndryshohet si vijon: “Për dallim nga regjistrat themeltarë origjinalë, kopjet e tyre ruhen në një objekt tjetër nga organi kompetent.”

Në nenin 11.5, fjalët : “libri burimor i amëzës” zëvendësohen me fjalët “origjinali i regjistrit themeltar” dhe fjalët “përshkrimi të librit burimor” me fjalët “rishkrimi nga origjinali.”

#### Neni 9

Neni 12.2, fshihet.

Neni 12.3, ndryshohet si vijon: “Regjistri themeltar ruhet nga zyrtari kompetent i zyrës së gjendjes civile, i cili kujdeset për sigurinë - mos dëmtimin dhe mos asgjësimin e tij.”

#### Neni 10

Në nenin 14, pika d. ndryshohet si vijon: “zyrtari i autorizuar i gjendjes civile.”

## Neni 11

Në nenin 21, pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3 si vijon: “Regjistrimi i adoptimeve të bëra jashtë Kosovës, bëhet në regjistrin themeltar kur adoptimi është bërë në harmoni me ligjin.”

## Neni 12

Në nenin 24, pas paragrafit 12 shtohet paragrafi 13 si vijon: “Me rastin e lidhjes së martesës, zyrtari i gjendjes civile do t’u japë bashkëshortëve “Broshurën familjare” dhe një certifikatë, si dëshmi se martesa është lidhur. Të dhënat e shënuara në “Broshurën familjare” duhet të jenë të njëjta me të dhënat e shënuara në regjistrat themeltarë. Përmbajtja dhe procedurat e tjera të “Broshurës familjare” janë të përcaktuar me Ligjin e gjendjes civile.”

## Neni 13

Neni 25.1, ndryshohet si vijon: “Personat që dëshirojnë të lidhin martesë duhet t’i paraqesin kërkesë zyrtarit kompetent të zyrës së gjendjes civile, në territorin e së cilës njëri nga ata ose të dytë e kanë vendbanimin e përhershëm.”

Neni 25.5, ndryshohet si vijon : “Qytetari i Kosovës, për të nxjerrë certifikatën e statusit martesor duhet të jetë prezent, në rast se ndodhet jashtë vendit duhet të sjellë, përmes personit të autorizuar, certifikatën e statusit martesor ose deklaratën e vërtetuar nga noteri në shtetin ku jeton.”

## Neni 14

Në nenin 27.1, pika b) fjala “viti i lindjes”, zëvendësohet me fjalën “ datëlindja”.

## Neni 15

Në nenin 30, pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3, si vijon: “Certifikata e lindjes dhe e statusit martesor, konsiderohen të vlefshme kur përmbajnë shënime lidhur me statusin martesor, lëshohen nga zyra e gjendjes civile e që nuk janë më të vjetra se 6 muaj, në momentin e lidhjes së martesës.”

## Neni 16

Neni 31.1, ndryshohet si vijon: “Personat shtetas të huaj, me qëndrim të përkohshëm në Kosovë, lidhin martesë në zyrën komunale të gjendjes civile sipas vendbanimit ose vendqëndrimit.”

#### Neni 17

Neni 33.3, ndryshohet si vijon: “Kërkesa për regjistrimin e vdekjes në regjistrin e të vdekurve duhet bërë brenda 30 ditëve nga ndodhja ose gjetja e kufomës dhe brenda 60 ditëve, kur vdekja ka ndodhur jashtë shtetit.”

Neni 33.9 ndryshohet si vijon: “Faktin e vdekjes pa vërtetimin e entit mjekësor zyrtari i gjendjes civile mund ta regjistroj me dëshminë e dy dëshmitarëve të cilët kanë njohuri lidhur me vdekjen”.

Pas paragrafit 9, shtohet paragrafi 10, si vijon: “Me kalimin e afatit të paraparë me paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, regjistrimin e vdekjes në regjistrin e të vdekurve zyrtari i gjendjes civile mund ta bëjë vetëm me vendim të organit komunal kompetent të gjendjes civile.”

#### Neni 18

Neni 38.19, ndryshohet si vijon: “Çertifikatat e lindjes, martesës dhe vdekjes janë të paafatizuara, përveç rasteve të lidhjes së martesës, nënshkruhen nga zyrtari i gjendjes civile dhe vulosen me vulë përkatëse.”

#### Neni 19

Në nenin 41.2, fjala “ofiqarëve” zëvendësohet me fjalët “zyrtarëve të gjendjes civile”;

Neni 41.5, ndryshohet si vijon: “Kur mbikëqyrja dhe kontrolli bëhen nga institucionet përkatëse kompetente për gjendjes civile, zyrtarit kompetent të gjendjes civile të zyrës amë janë të obliguar të ofrojnë të dhënat e kërkuara pa pengesë, si dhe të lejojnë të shikohen dhe të kontrollohen dokumentet.”

#### Neni 20

Teksti i këtij ligji, pas miratimit dhe hyrjes në fuqi, do të unifikohet me tekstin e Ligjit për regjistrat e gjendjes civile nr. 2004/46, pra do të bëhet një tekst i vetëm, i cili do të jetë më i lehtë për t’u kuptuar dhe zbatuar nga Shërbimi i gjendjes civile.

#### Neni 21

Ky ligj hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

**Ligji Nr. 02/L-126**  
**27 shtator 2007**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës,**

---

**Kolë Berisha**